

# LIGJ PËR TAKSAT KOMUNALE

TEKST I KONSOLIDUAR <sup>1</sup>

**Teksti në  
gjuhën  
Maqedonase**  
 Закон за  
комуналните такси

## Dispozita të përgjithshme

### Neni 1

Me këtë ligj rregullohen taksat komunale të cilat paguhen për shfrytëzimin e të drejtave të caktuara, të sendeve dhe shërbimeve në interes publik me rëndësi lokale, nga ana e personave juridikë dhe fizikë të cilët kryejnë veprimtari dhe nga qytetarët.

### Neni 2

(1) Taksat komunale paguhen sipas Tarifës për taksa komunale e cila është pjesë përbërëse e këtij ligji.

(2) Lartësinë e taksave komunale nga paragrafi 1 i këtij neni, në suazat e përcaktuara me Tarifën, me vendim e përcakton Këshilli i Komunës, Këshilli i komunave në qytetin e Shkupit dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit.

## Objekti i tatimit

### Neni 3

(1) Taksat komunale paguhen për:

- 1) çdo firmë, gjegjësisht emërtim të lokalit afarist;
- 2) shfrytëzimin e sipërfaqeve si kampe për ngritjen e çadrave dhe përdorim tjetër të ngjajshëm të përkohshëm;
- 3) shfrytëzimin e hapësirës para lokalit afarist për kryerjen e veprimtarisë;
- 4) vendosjen e reklamave, njoftimeve dhe shpalljeve në vende publike;
- 5) shfrytëzimin e muzikës në lokalet publike;
- 6) vendosjen e vitrinave për ekspozimin e mallrave jashtë nga ndërtesat afariste;
- 7) shfrytëzimin e shesheve dhe hapësirës tjetër në qytetet dhe vendbanimet tjera me qëllim të ekspozimit të sendeve, organizimin e ekspozitave dhe shfaqjeve tjera argëtuese për kryerjen e veprimtarisë;
- 8) shfrytëzimin e hapësirës për parkimin e veturave, automjeteve transportuese dhe rimorkiove të tyre dhe autobusëve, që për atë qëllim do t'i caktojë komuna,
- 9) shfrytëzimin e rrugëve me vetura, automjete transportuese, autobusë, automjete të posaçme dhe motoçikleta, dhe
- 10) shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik;

(2) Sipas paragrafit 1, pika 5 e këtij neni, me lokale publike nënkuptohen objektet hoteliere (kafenetë, restorantet dhe ngjajshëm) dhe pjesët

afariste anekse të tyre (lulishtet, teracat dhe ngjashëm).

(3) Me nocionin shfrytëzues i ndriçimit publik, nga paragrafi 1, pika 10 e këtij neni, nënkuptohet çdo posedues i kontatorit elektrik të kategorisë "amvisëri" dhe çdo posedues i kontatorit elektrik të kategorisë "konsumim tjetër".

## **Detyrës i taksës komunale**

### **Neni 4**

Detyrës i taksës komunale është personi fizik dhe juridik dhe qytetari, të cilët shfrytëzojnë të drejta të caktuara, sende dhe shërbime për shfrytëzimin e të cilave është përcaktuar pagim i taksës komunale.

## **Caktimi i lartësisë së taksës komunale**

### **Neni 5**

(1) Taksat komunale përcaktohen në lartësi të njëjtë për të gjithë detyrësit të cilët kryejnë veprimtari ose profesion të njëjtë, gjegjësisht për të gjithë detyrësit e kategorisë së njëjtë.

(2) Lartësia e taksës komunale nuk mund të caktohet sipas vlerës së sendit, qarkullimit të bërë ose të hyrave të realizuara.

(3) Taksa komunale për firmë, gjegjësisht për emërtim nga neni 3, paragrafi 1, pika 1 e këtij ligji, përcaktohet në mënyrë të ndryshme sipas llojeve të veprimtarive.

(4) Taksat komunale nga neni 3 paragrafi 1, pikat 2, 3 dhe 6 të këtij ligji, përcaktohen me metër katror sipërfaqe të shfrytëzueshme.

(5) Taksa komunale për shfrytëzimin e hapësirës për parkim nga neni 3, paragrafi (1), pika 8 të këtij ligji, përcaktohet në shumë procentuale nga çmimi i shërbimit të arkëtuar për shfrytëzimin e hapësirës për parkim.

## **Lirimi nga pagimi i taksave komunale**

### **Neni 6**

(1) Taksa komunale nuk paguhet për:

1) firmë të organeve shtetërore, të organeve të komunës, të organeve të komunave në qytetin e Shkupit dhe të organeve të Qytetit të Shkupit, institucionet publike, ndërmarrjet publike dhe organizatat joprofitabile;

2) shfrytëzimin e sendeve, shërbimeve dhe tokës nga ana e njësisve ushtarake dhe institucioneve;

3) vendosjen e reklamave, njoftimeve dhe shpalljeve në vende publike, të cilat kanë të bëjnë me punët në kompetencë të organeve shtetërore, të organeve të komunës, të organeve të komunave në qytetin e Shkupit dhe të organeve të Qytetit të Shkupit, si edhe me veprimtarinë e institucioneve publike, ndërmarrjeve publike dhe organizatave joprofitabile,

4) vendosjen e vitrinave të cilat gjenden në ndërtesat afariste ose në panairët;

5) firmë, gjegjësisht emërtimin e lokaleve afariste në vendbanimet pasive me migracion të theksuar; dhe

6) firmë të ushtruesve të profesioneve deficitare dhe zejtarive në zhdukje.

(2) Lirohen nga pagimi i taksës komunale nga neni 3, paragrafi 1, pika 10 e këtij ligji, poseduesit e kontatorëve për matjen e energjisë elektrike në vendbanimet ku nuk ka ndriçim publik.

(3) Vendbanimet pasive nga paragrafi (1), pika 5 të këtij neni, profesionet deficitare dhe zejet në zhdukje nga paragrafi (1), pika 6 të këtij neni dhe vendbanimet ku nuk ka ndriçim publik nga paragrafi 2 i këtij neni, i përcakton me vendim Këshilli i Komunës, Këshilli i komunave në qytetin e Shkupit dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit.

## **Përcaktimi dhe arkëtimi i taksës komunale**

### **Neni 7**

Obligimi për pagimin e taksës komunale lind në çastin e shfrytëzimit të së drejtës, sendit ose shërbimit për të cilat është caktuar pagimi i taksës.

### **Neni 8**

(1) E drejta e përcaktimit dhe e arkëtitimit të taksave komunale, parashkruhet dy vjet pas skadimit të vitit në të cilin është dashur të bëhet përcaktimi i taksës, respektivisht të arkëtohet taksa.

(2) E drejta e kthimit të taksës komunale të arkëtuar më tepër, parashkruhet dy vjet pas skadimit të vitit në të cilin është paguar taksa.

### **Neni 9**

(1) Kryetari i komunës, prefekti i komunave në qytetin e Shkupit dhe prefekti i Qytetit të Shkupit, detyrësit të taksës komunale i lëshojnë vendim në afat prej 30 ditësh për lartësinë e taksës komunale.

(2) Arkëtimi i taksave komunale nga neni 3 i këtij ligji, për shfrytëzimin e sipërfaqeve si kampe për ngritjen e çadrave dhe përdorim tjetër të ngjashëm të përkohshëm, për shfrytëzimin e hapësirës para lokaleve afariste për kryerjen e veprimtarisë, për shfrytëzimin e hapësirës për parkimin e automjeteve dhe rimorkiove të tyre, motoçikletave, motorëve dhe biçikletave, për vendosjen e reklamave, njoftimeve dhe shpalljeve në vende publike dhe për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik, bëhet pa lëshimin e vendimit në suazat e shumës së përcaktuar në Tarifën për taksat komunale.

(3) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni mund të ngrihet kontest administrativ para gjykatës kompetente.

### **Neni 10**

(1) Taksat komunale paguhen në shumë vjetore ose në përpjesëtueshmëri me kohën e shfrytëzimit të të drejtave, sendeve ose shërbimeve.

(2) Taksat komunale nga neni 3, paragrafi 1, pikat 1, 5, 6 dhe 9 të këtij ligji, paguhen në shumë vjetore, ndërsa nëse përcaktohen për kohë më të shkurtër se një vjet, paguhen në gjysmëvjetor, respektivisht më së paku në tremujor, ndërsa taksat komunale nga pikat 2, 4, 7 dhe 8 nga neni 3 i këtij ligji, paguhen në përpjesëtueshmëri me kohën e shfrytëzimit të të drejtave, sendeve ose shërbimeve.

(3) Taksa komunale nga neni 3, paragrafi 1, pika 3 paguhet çdo ditë.

(4) Taksa komunal nga neni 3, paragrafi 1, pika 10 i këtij ligji, paguhet çdo muaj.

### **Neni 11**

(1) Kryetari i komunës, prefekti i komunave në qytetin e Shkupit dhe prefekti i Qytetit të Shkupit, sipas të dhënave nga gjendja më 1 janar, çdo vit për çdo detyrës veçmas me vendim në afat prej 30 ditësh e përcakton shumën e taksës e cila duhet të paguhet.

(2) Detyrësit e taksës komunale nga paragrafi 1 i këtij neni, janë të obliguar taksën ta paguajnë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit.

### **Neni 12**

(1) Nëse gjatë vitit lind obligimi për pagimin e taksës komunale nga neni 11 i këtij ligji, ose ndodhin ndryshime të cilat sjellin deri në pagimin e taksës në shumë më të lartë ose më të ulët, detyrësi i taksës është i obliguar që në afat prej 15 ditësh nga dita e obligimit të lindur ose ndryshimit të ndodhur, për atë të parashtrojë fletëparaqitje të administrata komunale, te komunat në qytetin e Shkupit dhe te qyteti i Shkupit.

(2) Kryetari i komunës, prefekti i komunave në qytetin e Shkupit dhe prefekti i Qytetit të Shkupit, me vendim në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës do ta përcaktojnë lartësinë e taksës në shumë vjetore dhe do ta ngarkojnë detyrësin ta paguajë taksën në afat prej 15 ditësh nga dita e dërgimit të vendimit.

(3) Detyrësi i taksës komunale i cili nuk do të paraqesë në kohë fletëparaqitje sipas paragrafit 1 të këtij neni, do të ngarkohet, përveç me taksën e rregullt, me taksë të zmadhuar për 30%.

### **Neni 13**

(1) Detyrësit e taksës nga neni 3, pika 5 i këtij ligji, janë të obliguar që lindjen e obligimit të taksës t'ia paraqesin administratës komunale, të komunës, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit, në afat prej pesë ditësh pas pranimit të lejes për shfrytëzimin e muzikës.

(2) Në bazë të fletëparaqitjes nga paragrafi 1 i këtij neni, përcaktohet lartësia e taksës për kohën për të cilën është lejuar shfrytëzimi i muzikës, me marrjen e aktvendimit në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të fletëparaqitjes e cila i dorëzohet obliguesit.. <sup>2</sup>

(3) Nëse taksa ka të bëjë për kohë më të shkurtër se një muaj, detyrësi është i obliguar ta paguajë menjëherë. Nëse ka të bëjë për më shumë muaj, ajo paguhet në këste të njëjta mujore dhe atë që më parë, e më së voni deri më 5 në muajin për muajin rrjedhës.

### **Neni 14**

(1) Taksa nga neni 3, pika 4 i këtij ligji, llogaritet në bazë të fletëparaqitjes së detyrësit, e cila paraqitet para vendosjes së reklamës, njoftimit gjegjësisht shpalljes.

(2) Taksa nga paragrafi 1 i këtij neni, paguhet menjëherë.

### **Neni 15**

Mënyra e shfrytëzimit të mjeteve nga taksa komunale e cila paguhet për përdorimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik, rregullohet me akt të komunës, komunave në qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit.

## **Neni 16**

Sa i takon përcaktimit dhe arkëtimit të taksave komunale, mbikëqyrjes inspektuese mbi arkëtimin e taksave komunale, si edhe për mbikëqyrjen mbi punën e organeve të komunës, organeve të komunave në qytetin e Shkupit dhe organeve të Qytetit të Shkupit, shtyrjes së ekzekutimit, procedura me mjetin juridik, kamatës, arkëtimit me detyrim, kthimit të taksës të arkëtuar më tepër ose të paguar gabimisht, zbatohen dispozitat e Ligjit për tatimet mbi pronën.

## **Mbikëqyrja**

### **Neni 17**

Mbikëqyrje mbi zbatimin e këtij ligji dhe mbi rregullat e nxjerra në bazë të tij, bën Ministria e Financave-Drejtoria e të Hyrave Publike.

## **Dispozitat për kundërvajtje**

### **Neni 18**

(1) Gjobë në shumë prej 3,000 euro në kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik përkatësisht tregtari individual nëse:

- 1) nuk e paguan shumën e përcaktuar të taksës, brenda afatit të përcaktuar (neni 11, paragrafi (2) dhe neni 13, paragrafi (3)) dhe
- 2) nuk paraqet fletëparaqitje pranë administratës komunale, te komunat në qytetin e Shkupit dhe te qyteti e Shkupit, për obligimin e krijuar të taksës (neni 12, paragrafi (1) dhe neni 13, paragrafi (1)).

(2) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik përkatësisht tregtarit individual, do t'i shqiptohet personit përgjegjës të personit juridik përkatësisht tregtarit individual për kundërvajtjen nga paragrafi (1) të këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 200 deri në 500 euro në kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje të bërë personit i cili bën veprimtari të pavarur, për kundërvajtjet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Gjobë në shumë prej 200 deri në 500 euro në kundërvlerë në denarë, për kundërvajtje të bërë do t'i kumtohet qytetarit për kundërvajtjet nga paragrafi (1) i këtij neni.

### **Nenin 18-a**

Matja e lartësisë së gjobës për personin juridik përkatësisht tregtar individual kryhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

### **Neni 18-b**

Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet kryetarit të komunës, nëse në afatin e përcaktuar ligjor nuk merr aktvendim (neni 9 paragrafi (1), neni 11 paragrafi (1), neni 12 paragrafi (2) dhe neni 13 paragrafi (2)).

Për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni procedurë kundërvajtëse mban edhe sanksion kundërvajtës e shqipton gjykata kompetente.

## Neni 19

Gjobat e arkëtuara nga neni 18 i këtij ligji, janë të hyra të komunës, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit, në pajtim me ligjin.

## Neni 20

Taksat komunale paguhen sipas kësaj:

### TARIFA PËR TAKSAT KOMUNALE

shuma në denarë.

#### Numri tarifor 1

Për firmë, respektivisht emërtimin e:

a) lokaleve afariste të personave fizik të cilët kryejnë veprimtari	prej 1.300 deri 2.700
b) lokaleve afariste të personave fizikë të cilët kryejnë veprimtari ndërsa tatimin e paguajnë në shumë paushale	prej 350 deri 700
c) lokaleve afariste të shoqërive tregtare dhe personave të tjerë juridikë, nga lëmi i prodhimit, qarkullimit dhe shërbimeve, përveç për dyqane, qoshqe, njësi afariste dhe ngjashëm për të cilat taksa është 2 000	prej 4.000 deri 8.000
- lokaleve afariste të personave juridikë nga veprimtaritë komunale	prej 2.000 deri 4.000
- lokaleve afariste të shoqërive tregtare dhe të personave të tjerë juridikë, si edhe të pikave blerëse të cilat veprojnë kohë pas kohe	prej 2.000 deri 4.000

#### Numri tarifor 2

Për shfrytëzimin e sipërfaqeve në kampe për ngritjen e çadrave dhe përdorim tjetër të ngjashëm të përkohshëm - në ditë

prej 20
deri 40

Arkëtimin e taksës e bëjnë personat hotelier, turistik dhe persona të tjerë juridikë, ofruet të tjerë të shërbimeve hoteliere dhe turistike, personat fizikë të cilët kryejnë veprimtari hoteliere dhe turistike.

Ofruesit e shërbimeve, taksën e arkëtuar e paguajnë në llogarinë përkatëse për pagim, në suazat e llogarisë së trezorit për komunën, për komonat në qytetin e Shkupit dhe për Qytetin e Shkupit, në rajonin e të cilit është bërë arkëtimi.

#### Numri tarifor 3

Për shfrytëzimin e hapësirës para lokaleve afariste për kryerjen

prej 5
--------

e veprimtarisë për m<sup>2</sup> në ditë

deri 15

Arkëtimin e taksës e bën organi kompetent për lëshimin e lejes për kryerjen e veprimtarisë dhe e paguan në llogarinë përkatëse për pagim, në suazat e llogarisë së trezorit për komunën, për komunat në qytetin e Shkupit dhe për Qytetin e Shkupit, në rajonin e të cilit është bërë arkëtimi.

#### **Numri tarifor 4**

Për vendosjen e reklamave, njoftimeve dhe shpalljeve në vende publike, paguhet taksë edhe atë:

- deri në shtatë ditë	prej 400 deri 800
- deri në 30 ditë	prej 700 deri 1.300
- deri në një vjet	prej 800 deri 1.600

#### **Numri tarifor 5**

Për shfrytëzimin e muzikës në lokale publike - në vjet	prej 3.300 deri 6.700
--	-----------------------

#### **Numri tarifor 6**

Për vendosjen e vitrinave për ekspozimin e mallrave jashtë nga lokalet afariste, paguhet taksë vjetore edhe atë:

- për persona fizikë të cilët kryejnë veprimtari	prej 700 deri 1.300
- për personat juridikë nga lëmi i prodhimtarisë, qarkullimit dhe shërbimeve	prej 1.300 deri 2.700

#### **Numri tarifor 7**

Për shfrytëzimin e shesheve dhe hapësirës tjetër në qytetet dhe vendbanimet tjera, me qëllim të ekspozimit të sendeve, organizimit të ekspozitave dhe shfaqjeve argëtuese për kryerje të veprimtarisë, paguhet taksë për sipërfaqen e zënë për m<sup>2</sup> në ditë prej 3 deri në 7 denarë.

Arkëtimin e taksës e bën organi kompetent për lëshimin e lejes për ekspozimin e sendeve, organizimin e ekspozitave dhe shfaqjeve argëtuese dhe e paguan në llogarinë përkatëse për pagim, në suazat e llogarisë së trezorit për komunën, për komunat në qytetin e Shkupit respektivisht për Qytetin e Shkupit, në rajonin e të cilit është bërë arkëtimi.

#### **Numri tarifor 8**

Për shfrytëzimin e hapësirës për parkim të automjeteve të udhëtareve, automjeteve ngarkuese, autobusëve dhe rimorkiove në parkingjet publike, arkëtohet taksë komunale në lartësi prej 10% deri në 20% nga çmimi i shërbimit të arkëtuar për shfrytëzimin e hapësirës për parkim.

Arkëtimin e taksës e bën personi juridik, të cilit i është besuar organizimi dhe mirëmbajtja e vendparkimit dhe e paguan në llogarinë përkatëse për pagim, në suazat e llogarisë së trezorit për komunën, për komunat në qytetin e Shkupit dhe për Qytetin e Shkupit, në rajonin e të cilit është bërë arkëtimi.

#### **Numri tarifor 9**

Për shfrytëzimin e rrugëve me vetura, automjete transporti, autobusë, automjete të posaçme dhe motoçikleta dhe atë:

- për vetura deri në 1 000 kubikë	prej 30 deri 70
- për vetura prej 1 000 deri në 1 300 kubikë	prej 50 deri 100
- për vetura prej 1 300 deri në 1 500 kubikë	prej 70 deri 130
- për vetura prej 15 00 deri në 1 800 kubikë	prej 200 deri 400
- për vetura mbi 1 800 kubikë	prej 300 deri 600
- për automjete transporti sipas ton-bartjes	prej 70 deri 130
- për autobusë dhe automjete të tjera, të cilat shërbejnë për transportin e udhëtarëve	prej 350 deri 700
- për automjete të posaçme	prej 30 deri 70
- për të gjitha llojet e motoçikletave	prej 30 deri 70

Arkëtimin e taksës e bën organi kompetent për regjistrimin e automjeteve dhe e paguan në llogarinë përkatëse për pagim, në suazat e llogarisë së trezorit për komunën, për komunat në qytetin e Shkupit dhe për Qytetin e Shkupit, në rajonin e të cilit është bërë arkëtimi.

## Numri tarifor 10

(1) Për shfrytëzimin dhe për mirëmbajtjen e ndriçimit publik, paguhet taksë komunale sipas tipit të konsumatorëve edhe atë:

- 0,4KV (amvisëri)	nga 25KW/h
- 0,4KV (objekte të shoqërive tregtare dhe të zejtarëve)	nga 50KW/h
- 10KV	nga 100KW/h
- 35KV	nga 150KW/h dhe
- 110KV	nga 300KW/h

sipas çmimit për ndriçim publik, për çdo numëror për matjen e energjisë elektrike.

(2) Paguesa e mjeteve nga paragrafi (1) të këtij numri tarifor për komunat në Qytetin e Shkupit në rajonin e të cilit është bërë arkëtimi dhe Qytetit të Shkupit bëhet sipas kompetencës për mirëmbajtjen e ndriçimit publik në raport të caktuar me përqindje të përcaktuar me Ligjin për Qytetin e Shkupit.

(3) Arkëtimin e taksës për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik nga poseduesit e kontatorit e bën shoqëria tregtare kompetente për distribuimin e energjisë elektrike dhe e paguan në llogarinë përkatëse për pagim, në suazat e llogarisë së trezorit për komunën, për komunat në qytetin e Shkupit dhe për Qytetin e Shkupit në rajonin e të cilit është bërë arkëtimi.



# Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

## Neni 21

Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, pushon të vlejë Ligji për taksat komunale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 45/72, 39/77, 42/80, 51/88, 11/91 dhe 28/91, 34/92, 4/93, 17/93, 45/93, 33/95 dhe 71/96).

## Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të zbatohet prej ditës së konstituimit të Këshillave të komunave dhe Qytetit të Shkupit dhe zgjedhjes së prefektëve të komunave dhe prefektit të Qytetit të Shkupit pas zbatimit të zgjedhjeve të para të ardhshme lokale në pajtim me Ligjin për zgjedhjet lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër. 46/96, 12/2003, 35/2004, 52/2004 dhe 60/2004).

### DISPOZITA NGA NJË LIGJ TJETËR

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për taksat komunale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 92/2007):

#### Neni 4

Deri në përcaktimin e raportit me përqindje në Ligjin për Qytetin e Shkupit, pagesa e mjeteve nga neni 20 numri tarifor 10 paragrafi (1) të këtij ligji do të bëhet në raportin me përqindje si vijon:

	% për komunën	% për
Qytetin e Shkupit		
Aerodrom	60%	
40%		
Butell	70%	
30%		
Gazi Babë	75%	
25%		
Gjorçe Petrov	75%	
25%		
Karposh	60%	
40%		
Kisella vodë	70%	
30%		
Saraj	85%	
15%		
Qendër	40%	
60%		
Çair	70%	
30%		
Shuto Orizarë	90%	
10%		

Obligimet që dalin nga marrëdhëniet kreditore-debitore ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe shoqatës tregtare nga neni 20 numri tarifor 10 paragrafi (3) të këtij ligji të krijuara në bazë të energjisë së paarkëtuar elektrike për ndriçimin e rrugëve magjistrale dhe për tubime në rajonin e Qytetit të Shkupit nga të hyrat në bazë të taksës për ndriçimin e rrugëve të hedhura në llogarinë e komunave

në Qytetin e Shkupit në periudhën prej 1 korrik 2005 deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për taksat komunale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 154/2015):

**Neni 3**

Procedurat e filluara të ankesës në pajtim me Ligjin për taksa komunale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 61/2004, 64/2005, 92/2007 dhe 123/12), deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të kryhen në pajtim me ligjin me të cilin kanë filluar.

Lëndët në procedurën administrative të shkallës së dytë për të cilat ka vendosur ministri i Financave apo prej tij personi i autorizuar, e për të cilat është ngritur kontest administrativ deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të kryhen në pajtim me ligjin me të cilin ka filluar procedura.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për taksat komunale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 154/2015):

**Neni 4**

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për taksat komunale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 23/2016):

**Neni 7**

Procedurat e filluara deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji do të mbarohen në pajtim me ligjin sipas të cilat kanë filluar.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për taksat komunale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 23/2016):

**Neni 8**

Dispozitat e neneve 1, 2, 3 me të cilat ndryshohet neni 12 paragrafi (2) të Ligjit për taksa komunave, neni 4 me të cilin ndryshohet neni 13 paragrafi (2) të Ligjit për taksa komunale dhe neni 6 të këtij ligji, do të fillojë të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative në pajtim me nenin 141 të Ligji për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 124/15).